
**Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi / Direkcija za Poljoprivredu, Sumarstvo i
Vodoprivredu / Departament of Agriculture , Forestry and Hydro-economy**

09. Nr. 119/2021

Datë.05.11.2021

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomisë , bazuar ne vendimin e Kryetarit te
Komunës Nr. 01-629/021 te datës 03.11.2021 shpallë:

THIRRJE PER APLIKIM

Për subvencionimin e fermerëve qe mbarështojnë dhi qumështore

Ftohen të gjithë fermerët e interesuar te komunës se Istogut që të aplikojnë për mbështetje për
subvencionim për dhi qumështore;

Periudha e aplikimit:

Aplikimi zgjatë 15 ditë kalendarike dhe fillon që nga dita e shpalljes publike, nga data
05.11.2021 dhe përfundon më datë 19.11.2021 ne ora 16.00

Mënyra e aplikimit:

Aplikimi bëhet në Qendrën për Shërbim me Qytetar Nr: 100

Aplikacionet që nuk e kanë dokumentacionin e kërkuar sipas thirrjes nuk do të
shqyrtohen.

KRITERET QË DUHET T'I PLOTËSOJNË FERMERËT / APLIKUESIT:

- Të jenë banorë te komunës se Istogut;
- Të mbarështojnë së paku **5 krerë** dhi qumështore, në prodhimtarinë aktive të qumështit por jo me shumë se **60 krerë**
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara me matrikulë të Republikës së Kosovës
- Kafshët duhet të jenë të identifikuara dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV;

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM:

- Kopjen e letërnjoftimit
- Konfirmimi i llogarisë bankare
- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit (vetëm për personat juridik);
- Dëshmia për kryerjen e obligimeve ndaj komunës (Tatimi ne pronë) , obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Regjistri i kafshëve i lëshuar nga Praktikat veterinare të kontraktura nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV.